



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

*Dokument parlamentar
Tiranë më, 12.07.2018*

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR”

1.0 Hyrje

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit për Politikën e Jashtme, me cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 12.07.2018 shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor,” në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Në mbledhjen e komisionit prezantuan projektligjin z.Gazmend Barbullushi, Sekretar i Përgjithshëm MPEJ,znj. Elida Petoshati - Drejtoreshë e Rajonit dhe Vendeve Fqinje në MPEJ,z. Armand Skapi - Drejtor i Traktateve dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare në MPEJ.

2.0 Nisma ligjvënëse

Bazuar në nenin 81 pika 1, nenit 100 të Kushtetutës së Shqipërisë, ky projektligj vjen me iniciativën ligjvënëse të Këshillit të Ministrave .

3.0 Baza Kushtetuese e projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78,83, pika 1 dhe nenit, 121 pika 1 të Kushtetutës.

4.0 Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

1. Qëllimi i projektligjit

Marrëveshja ka si qëllim kryesor përcaktimin e rregullave të funksionimit të Fondit, statusin ligjor dhe privilegjet e imunitetet e stafit që do të ushtrojë aktivitetin në këtë strukturë.

Projektligji synon realizimin e objektivave të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë, të parashikuara në programin e Këshillit të Ministrave për politikën e jashtme dhe, veçanërisht, objektivit për thellimin e bashkëpunimit rajonal, i cili është një ndër parimet bazë që udhëheqin politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Republika e Shqipërisë, ndër të tjera, merr përsipër të angazhohet në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal e ndërkombëtar si dhe në zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, prej nga i lind edhe detyrimi për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për bashkëpunimin rajonal, synimi i të cilave është rritja e fushave të bashkëpunimit dhe përforcimi i këtij bashkëpunimi ndërmjet vendeve në fjalë, siç është edhe marrëveshja për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Kjo marrëveshje, ndihmon në zbatimin e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, e cila përbën një objektiv strategjik për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, nëpërmjet evidentimit të rolit të saj konstruktiv në rajon.

Marrëveshja për Krijimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor (FBP) u nënshkrua në Pragë nga ministrat e punëve të jashtme të Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Maqedonisë, Kosovës dhe Serbisë, në nëntor të 2015, në kuadër të Konferencës vjetore të Ministrave të Punëve të Jashtme të vendeve të Vishegradit (Çeki, Hungari, Poloni, Sllovakia) dhe atyre të Ballkanit Perëndimor .

Fondi i Ballkanit Perëndimor është një Organizëm Ndërkombëtar me seli në Tiranë. Fondi ka strukturat e tij. Sekretariatit, Drejtorin Ekzekutiv, Këshillin e Zyrtatëve të Lartë dhe Këshillin e Ministrave të Jashtëm, si organi më i lartë vendim marrës.

Pranimi nga vendet anëtare të FBP-së për vendosjen e selisë së Fondit në Tiranë dhe zgjedhjen e drejtorit të parë ekzekutiv nga Shqipëria tregon për kontributin dhe rolin që ka luajtur dhe luan Shqipëria në Rajon.

Qëllimi i Fondit të Ballkanit Perëndimor është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anetare, forcimi i lidhjeve midis tyre, integrimi drejt Bashkimit Evropian dhe Natos, promovimi i vlerave të përbashkëta mes qytetarëve, shoqërisë civile dhe institucioneve të rajonit të Ballkanit perëndimor, duke siguruar një qasje konkrete në nivelin “people-to-people” për popujt e vendeve anëtare, duke ndihmuar në ruajtjen dhe konsolidimin e paqes dhe stabilitetit demokratik.

Këto qëllime Fondi synon ti realizojë përmes mbështetjes së projekteve të përbashkta. Kjo gjykohet si rruga më e mirë për të afruar njerëzit, për të shkëmbyer eksperiencat e ndërsjellta, për të njofur më mirë vlerat, traditat dhe kulturën e vendeve respektive. Procesi i përgatitjes dhe zbatimit të projekteve nga aktorët rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, institucioneve

qëndrore apo në nivel lokal, gjykohet se do të shërbejë rritjes së kapaciteteve për të përgatitur në të ardhmen, projekte më të mëdha e më komplekse.

Fondi i Ballkanit Perëndimor do të financojë projekte të vogla dhe të mesme që synojnë rritjen e bashkëpunimit rajonal, ndërkufitar dhe forcimin e kohezionit rajonal, në këto fusha kryesore: edukimi, arsimi, mbrojtja e mjedisit, të drejtat e njeriut, kultura, shkëmbimet ndërkufitare dhe bashkëpunimi rinor.

Mekanizmi i aplikimit për financim do të jetë i thjeshtë dhe i arritshëm si për individët ashtu edhe për organizatat rinore, rrjetet rajonale të shoqërisë civile, komunitetin e biznesit, institutet kërkimore dhe akademike etj.

Formalizimi i këtij procesi nëpërmjet *ratifikimit të marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor*”, përveç rëndësisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal, është përfundim i natyrshëm i përpjekjeve të mëdha diplomatike për të sjellë në vend për herë të parë selinë e një nisme rajonale.

1.1 Përmbajtja e projektligjit

Marrëveshja me vendin pritës, e nënshkruar më 19.4.2018, është bazuar në statutin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, pjesë e marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor.

Marrëveshja me vendin pritës është strukturuar me 2 pjesë; pjesën hyrëse “preambula” dhe 24 nene ku sanksionohen :

- -termat e marrëveshjes;
- -privilegjet dhe imunitetet e nevojshme për funksionimin e sekretariatit të Fondit;
- selia, statusit ligjor të Fondit, të drejtën që sekretariati i Fondit të përdorë flamurin dhe simbolet e tij;
- -përfshirje nga taksat për Sekretariatit të Fondit dhe përdorimin e fondit të tij, në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike, të akredituara në Shqipëri;
- -zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të cilat do të realizohen me negociata ndërmjet palëve.
- kohën e hyrjes në fuqi e cila është dita kur Republika e Shqipërisë njofton Sekretariatit të Fondit se ka përfunduar procedurat e brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

5.0 Efektet financiare

Zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte direkte nga pikëpamja buxhetore, pasi ambienti ku ka selinë Sekretariati i Fondit, i ofruar pa pagesë, për një periudhë 5- vjeçare, bërë në zbatim të marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor, arritur në Pragë më 13 tetor 2015, është pronë e shtetit shqiptar, e cila administrohet nga Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik. Vlera e përafërt që do të përfitohej nga dhënia me qira e këtij ambienti, për 5 vjet, ku do të përfshiheshin pagesat për (qira, ujë, drita dhe kancelari) është rreth 72 000.00 euro.

Përveç shumës së sipërpërmendur, pala shqiptare nuk do të vjelë ato tatime dhe taksa për të cilat Fondi dhe stafi ndërkombëtar janë të përjashtuar si përfitues të privilegjeve të njohura edhe nga Konventa e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike.

6.0 Diskutimet në Komision :

Deputetet në diskutimet e tyre vlerësuan rëndësinë e projektligjit dhe bënë pyetje konkrete duke kërkuar sqarime për përmbajtjen e nenit 2 dhe 5 të marrëveshjes , sa projekte janë përgatitura nga Fondi, se si realizohen informimi i OJF-ve apo institucioneve për projekte dhe mundësinë e këtyre të fundit për të marre pjese si aplikant dhe përfitues të projekteve.

Në përgjigje të përfaqësuesve të Ministrisë për Europën dhe Punët e jashtme u dhanë sqarime për përmbajtjen e dispozitave të marrëveshjes , sqaruan se Fondi ka përgatitur 18 projekte ku në to përfshihen projekte me bazë gjinore, për zhvillimin e qëndrueshme dhe përfitues janë Bashki , si dhe përfaqësues nga shoqëria civile.

6.0 Aspekti procedural i projektligjit

Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për ratifikim në zbatim të nenit 81, pika 1 dhe 121 pika 1, shkronja “c”, të Kushtetutës.

Kjo marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë , Kreu II”Marrëveshjet Ndërkombëtare, në neni 121 i saj. Marrëveshja është hartuar, mbështetur në pikën 2, të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” në të cilën thuhet “

1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj.

2. Ministria kompetente i paraqet për shqyrtim Këshillit të Ministrave, brenda 30 ditëve pune nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, propozimin për ratifikimin e marrëveshjes, të shoqëruar nga dokumentet e mëposhtme:

a) projektligji për ratifikim;

b) projektvendimi për propozimin e projektligjit;

c) vendimi i miratimit në parim;

ç) tekstet e marrëveshjes së nënshkruar në gjuhën shqipe dhe angleze ose përkthimi i certifikuar, në mungesë të nënshkrimit në gjuhën shqipe;

d) relacioni shpjegues, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 8, të këtij ligji;

dh) mendimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe i Ministrisë së Drejtësisë për përmbajtjen e projektligjit.

3. Ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet nga Kuvendi. Projektligji, i shoqëruar me dokumentet e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, i kalon për ratifikim Kuvendit “

Procedura e ndjekur për hartimin e nënshkrimit të marrëveshjes “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor “është në përputhje me parashikimet e ligjit 43/2016 ‘Për Marrëveshje ndërkombëtare.’”

Në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim dhe në tërësi , me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

KRYETARE

Mimi KODHELI